

**NDIKIMI I KAPITALIT SOCIAL NË PERFORMANCËN
ARSIMORE SI FAKTOR I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM**

**ВЛИЈАНИЕТО НА СОЦИЈАЛНИОТ КАПИТАЛ ВО
ОБРАЗОВНАТА ПЕРФОРМАНСА КАКО ФАКТОР ЗА
ОДРЖЛИВ РАЗВОЈ**

**THE IMPACT OF SOCIAL CAPITAL, FACTOR OF
EDUCATIONAL PERFORMANCE IN THE DEVELOPMENT OF
SUSTAINABILITY PRACTICES**

Abstract

Education plays an important role in the overall development and sustainable development of all societies, a truth universally acknowledged by intellectuals of all scientific fields, and as such, this idea is nothing. The question that should be discussed is that despite the fact that almost all societies develop education and educational processes through relevant institutions, visible differences still emerge between different societies.

Why does this happen? How can we explain that some countries have sustainable development at a high level, have a developed democracy, economic prosperity and a good education system, etc? Which factors affect the improvement of quality of social and political processes in society, including education? We must consider that a wide variety of dimensions can play a role in this discussion, including historical, geographical, philosophical, political, etc. Nevertheless, research in numerous studies by social scientists indicate that an important factor for the achievements of some countries in all spheres of social and political life have attributed the presence of social capital at high levels in those societies.

This paper will address precisely this concept of social capital as a social value that helps improve the quality of all social processes. A content analysis will be conducted of the role and impact that social capital has on educational performance, while at the same time considering the role of quality education in sustainable development.

Keywords: social capital, education, sustainable development, schools, the environment, social networks.

HYRJE

Bota sot lëviz me një dinamikë të shpejtë dhe si rezultat i zhvillimit teknologjik ajo pëson ndryshime të shumta në të gjitha dimensionet, si në atë ekonomik, politik, kulturor dhe të mjedisit. Këto ndryshime me vete bartin edhe shumë të panjohura për të ardhmen, veçanërisht për atë pjesë e cila nuk është kyçur në këto procese dhe për ata të cilët u mungojnë informacionet dhe njohuritë e duhura për efektet dhe pasojat që sjell globalizimi. Natyrisht, mund të konstatojmë se meqenëse bota nuk zhvillohet njëtrajtshëm dhe në mënyrë të barabartë, atëherë edhe efektet dhe pasojat nga proceset globalizuese nuk janë të njëjta për të gjitha vendet. Kështu që vetëkuptohet se vendet e pazhvilluara dhe ato më pak të zhvilluara në mungesë të njohurive dhe informacioneve të nevojshme ndjejnë veten të rrezikuar nga këto procese.

Atëherë me të drejtë shtrohet pyetja se si ka ndodhur që disa shtete të jenë më të zhvilluara ndërsa disa të tjera më pak, e disa aspak të zhvilluara. Çfarë i ka bërë disa shtete më superiore në aspektin ekonomik, politik dhe kulturor kundrejt shteteve të tjera që nuk arrijnë në të njëjtin nivel të zhvillimit.

Studiues të shumtë janë marrë me hulumtime dhe analiza të gjëra e të thella si nga lëmenjtë e shkencave natyrore po ashtu edhe nga sfera e shkencave shoqërore, të cilët këtë dukuri e shpjegojnë me ndikimin e faktorëve të ndryshëm në ndërtimin e strukturës shoqërore.

Për studimin tonë ne kemi veçuar rëndësinë e konceptit të kapitalit social si njëri nga faktorët shoqëror për ngritjen e performancës arsimore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, studim ky që trajtohet nga këndvështrimi sociologjik. Prandaj, në këtë studim do të elaborohen me seriozitetin e duhur disa koncepte bazë siç janë besimi social si kusht për kapitalin social, vetë kapitali social si kategori dhe vlerë bashkëkohore e shoqërive të zhvilluara, mandej raportin dhe ndërlidhjen midis kapitalit social dhe arsimit cilësor, zhvillimin njerëzor, kapitalin njerëzor, si dhe konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm si një

fenomen i shoqërive bashkëkohore. Për të gjitha këto koncepte bazë, do të jepen definicione dhe pikëpamje të disa studiuesve të njohur botëror si dhe do të jepen shembuj nga praktikat e disa vendeve të zhvilluara që në strukturën e tyre dhe në jetën e përditshme kanë implementuar këto koncepte. Duke nxjerrë në pah marrëdhënien e ngushtë midis këtyre koncepteve, do të orvatemi të nxjerrim përfundimin se si këto koncepte dhe raporti midis tyre përbëjnë një hallkë të rëndësishme të këtyre shoqërive të cilat njëkohësisht bëjnë diferencën e shteteve të zhvilluara nga ato më pak të zhvilluara.

Besimi social si faktor për ndërtimin e kapitalit social

Koncepti i besimit social është një koncept kyç dhe shumë i diskutuar kohët e fundit. Mbi të gjitha, besimi social është një vlerë. Koncepte të tjera të përafërta me të janë morali, qëndrimet, zakonet. Koncepti, ose konstrukti, i besimit social përbën një kategori të ndërlikuar dhe pak të studiuar. Megjithatë, ata që e kanë studiuar, mbështeten në këndvështrimin e psikologëve dhe e shohin atë si një konstrukt psikologjik i cili shpreh një predispozicion të brendshëm të njeriut për të vepruar në drejtime, me persona e konstrukte, të cilat perceptohen si të parrezikshme.

Ne e dimë se në bashkëveprimet me të tjerët do të ndikojmë mbi ta dhe do të ndikohemi prej tyre. Pëlqimet tona personale janë që në këto bashkëveprime të mos dëmtohem. Në këtë kuadër, besimi shihet si një mekanizëm me të cilin ne e nisim bashkëveprimin me sigurinë se nuk do të dëmtohem gjatë bashkëveprimeve tona. Autorë të tillë si Wolfe, besimin e shohin në nivele të ndryshme dhe atë; në nivelin e marrëdhënieve shoqërore- besimi shihet si një cilësi e nevojshme për të arritur qëllime grupore; në nivelin e një sistemi të tërë shoqëror- besimi shihet si një vlerë të cilën e mbështet i gjithë sistemi shoqëror. Këto nivele janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin.

Me pak fjalë, besimi social është siguria se nuk do të dëmtoheni nga bashkëveprimet në të cilat hyjmë. Si rregull, besimi formohet më shumë në bashkësi të vogla, të mbyllura dhe homogjene. Studiuesit e kohës sonë e kanë parë besimin social të lidhur me faktorët individualë: disa individë dhe disa popuj piren të jenë më të besueshëm se disa të tjerë; e kanë parë të lidhur me faktorë socialë: disa shoqëri kanë pjesëmarrje dhe organizim më të lartë civil se disa shoqëri të tjera. Në këtë përpjekje do të vihet në dukje se çështja e besimit social është e lidhur sa me faktorët individualë aq edhe me ata socialë: niveli i besimit

është lidhur ngushtë me atë se çfarë niveli besimi/mosbesimi na ka injektuar konteksti ku jetojmë. Me këtë nivel besimi, ne bazojmë institucionet që arrijmë të ndërtojmë. Niveli i besimit është i lidhur ngushtë edhe me atë se çfarë bëjnë institucionet sociale që ne t'u besojmë apo mos t'u besojmë atyre. Një studiues ka bërë pyetjen e rëndësishme nëse mund të krahasohet besimi në një person me besimin në një institucion. Sigurisht që këto lloj besimesh nuk janë e njëjta gjë, por edhe një lidhje duket ta kenë. Në përpjekje për t'i shpëtuar shikimit ndarazi të besimit ndërpersonal me besimin në institucionet, në vijim do të përpiqemi t'i shohim të lidhura këto dy gjëra duke vënë në dukje të dhëna që burojnë nga Sondazhi Botëror mbi Vlerat. Besimi social përbën, mesa duket, një faktor esencial për formimin e institucioneve që kanë autoritet dhe që performojnë në dobi të qytetarëve. Por krahas kësaj, serioziteti i punës dhe performanca e institucioneve kanë një ndikim të dukshëm në zhvillimin e besimit qytetar.

Aspekti teorik dhe rëndësia e besimit social në shoqëri dhe raporti me kapitalin social

Besimi shihet nga studiues të ndryshëm si një mekanizëm që mbështetet në marrëdhëniet shoqërore, në normat që krijohen në strukturat e këtyre marrëdhënieve, dhe në institucionet shoqërore. Çështja e besimit social shihet si një çështje e rëndësishme në proceset shoqërore. Që njerëzit të mund të arrijnë objektiva bashkërisht, ata duhet të jenë të lidhur me njëri tjetrin dhe që të jenë të lidhur me njëri-tjetrin, ata duhet ta njohin dhe të kenë besim te njëri-tjetri. Besimi, rezulton të jetë një faktor i rëndësishëm në përpjekjet e përbashkëta për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Në shikim të parë ky raport duket i thjeshtë por nuk është kështu, prandaj me të drejtë lindin disa pyetje: kush na garanton se edhe tjetri do ta dojë qëllimin e përbashkët siç mund ta dua unë, kush na garanton se ai tjetri nuk do ta shfrytëzojë përpjekjen e përbashkët për përfitime personale, kush na garanton se ai tjetri nuk do të na mashtrtojë? Pra, që njeriu të zhvillojë besim te tjetri, nuk është e lehtë. Mirëpo, pa besim social nuk mund të kesh kapital social: njerëzit nuk lidhen me njëri tjetrin dhe nuk zhvillojnë norma. Zhvillimet e dekadave të fundit në fushat e sociologjisë, politologjisë dhe psikologjisë sociale në vendet e përparuara na tregojnë se zhvillimi demokratik është shumë i lidhur me kapitalin social, element thelbësor i të cilit është besimi social. Kapitali social është një kusht zhvillimi për një shoqëri moderne, të hapur, është

kusht për një shoqëri inkluzive, është kusht për rritjen e investimeve, është kusht për rritjen e ndjenjës së lumturisë dhe të mirëqenies. Siç do të trajtohet dhe gjetiu, çështja e kapitalit social, ashtu siç është formuluar nga teoricienët që janë marrë me të, por edhe nga studiuesit aplikativë, ka të bëjë me grupet dhe rrjetet, me besimin dhe solidaritetin, me veprimin kolektiv dhe bashkëpunimin, me informimin dhe komunikimin, me kompaktësinë sociale dhe përfshirjen, me veprimin politik, etj. Marrëdhënia midis besimit dhe kapitalit social shihet në mënyra të ndryshme. Disa studiues e shohin besimin si një parakusht për të pasur kapital social, ndërsa disa të tjerë e shohin atë si një produkt të kapitalit social. E vërteta është se ekziston një paqartësi jo e vogël në lidhjen mes kapitalit social dhe besimit social. Në fakt nuk ka një mirëkuptim të përgjithshëm për sa i përket çështjes nëse besimi është kusht për kapital social [siç mendojnë Coleman (1988), Putnam (1993), dhe Fukuyama (1995)], apo nëse besimi është produkt i kapitalit social [siç mendon shkencëtari Field (2003)].

Pra a duhet të kemi besim, që të kemi edhe kapital social, apo duhet të kemi kapital social, që të kemi besim, apo ato kushtëzojnë reciprokisht njëri-tjetrin?. Ata që e shohin besimin si parakusht të kapitalit social, pohojnë se marrëdhëniet, bashkësitë, bashkëpunimi, angazhimi etj., që karakterizojnë kapitalin social, nuk do të ekzistonin nëse mes njerëzve nuk do të kishte një nivel të caktuar besimi. Kësisoj mendohet se pa besim nuk ka kapital social. Nga ana tjetër studiuesit që mendojnë se besimi është produkt i kapitalit të caktuar social, mendojnë se besimi është produkt i marrëdhënieve dhe se, si produkt i tyre, ai është edhe produkt i vetë kapitalit social.

Sido që të jetë, mesa duket marrëdhënia midis besimit dhe kapitalit social duket të jetë një marrëdhënie e ndërlikuar, si për implikimet e shumta që ajo ka në jetë, ashtu edhe për ato që lidhen me studimin e saj. Kjo do të thotë se për të, priten studime të mëtejshme shkencore. Por gjithsesi ajo është një marrëdhënie e rëndësishme për proceset shoqërore në të cilat siç vërehet, kapitali social dhe besimi social luajnë një rol me peshë.

Kapitali social si vlerë bashkëkohore dhe roli i tij në shoqëri

Sipas Putmanit (2000) “kapitali social u referohet vlerave kolektive të të gjitha rrjeteve sociale”. “Ky është thelbi i shoqërive demokratike” - citon Putnam. Më tej Bourdieu (1993) në shpjegimin e tij për kapitalin social thotë se dallojmë tri forma të kapitalit: kapitalin social,

ekonomik dhe atë kulturor. I pari u referohet lidhjeve miqësore dhe familjare; i dyti pasurive financiare, ndërsa i treti lidhet me pjesëmarrjen kulturore. Rëndësia e këtij koncepti në këtë studim qëndron në faktin se kapitali social, duke qenë një formë e socializimit produktiv (Bourdieu, 1986: 76), mund të konvertohet edhe në kapital material e financiar. Pra, rrjetet familjare dhe shoqërore mund t'i ndihmojnë individët jo vetëm duke i mbështetur, por edhe duke i informuar. Si rezultat, individë, grupe e komunitete ndihmohen të dalin nga cikli vicioz i varfërisë. Duke iu referuar sërish Bourdieu-së, ai thotë se “lidhjet dhe njohjet shoqërore ndryshojnë jetën e njeriut dhe rrisin shanset e tij në jetë”. Janë këto lidhje, të cilat shndërrohen në institucione më mbështetëse për individët, por që ato të ekzistojnë, individët duhet të investojnë në socializimin përmes sistemit arsimor. Bourdieu (1996) thotë se “individët duhet të investojnë për socializimin e tyre”.

Roli i kapitalit social është t'i ndihmojë individët të ndihen më të përfshirë, por edhe të ndihmojë komunitetin për ndërmarrjen e nismave apo aksioneve kolektive, me qëllim që të përmirësohen ose zgjidhen problemet e komunitetit ku bëjnë pjesë. Studimet tregojnë (Lampland 2002) se në vendet ku kapitali social është i nivelit të lartë ndërmerren shumë nisma në ndihmë të komunitetit edhe nga vetë banorët. Po ashtu, ato dëshmojnë për rëndësinë që ka komuniteti edhe në përmirësimin e performancës arsimore, të gjendjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kapitali social dhe arsimit cilësor

Për shkak të ndryshimeve të shpejta dhe dinamike të mjedisit dhe shoqërisë, si dhe për shkak të apatisë së përgjithshme të strukturave shoqërore të cilat lejojnë që këto ndryshime të zhvillohen pa ndonjë kriter apo qëllim të qartë, vjen deri te cenimi dhe rrezikimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, me qëllim që të mos ndodhë kjo, shoqëritë duhet të orientohen në ngritjen e cilësisë së arsimit, në përgjithësi, sepse arsimit është kategoria më ekstrapulsive e zhvillimit ekonomik dhe instrumenti më strategjik për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme të kapitalit njerëzor. Meqenëse vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor zënë vendin e fundit në Evropë nga aspekti i zhvillimit njerëzor, klasat politike, politik-bërësit në arsim dhe shoqëria në tërësi, nuk duhet të angazhohen për çfarëdo lloj përparimi, sepse ai nuk është i mjaftueshëm për prosperitet ekonomik, zhvillim demokratik, sundim të ligjit dhe garantim të sigurisë së plotë për të gjithë qytetarët. Mirëpo, edhe

zhvillimi i qëndrueshëm dhe përparimi i rrënjëzuar nuk janë garantues të mjaftueshëm dhe nuk sigurojnë mirëqenien dhe lumturinë e qytetarëve, nuk e garantojnë paqen, nuk e sigurojnë prosperitetin dhe, përfundimisht, nuk e mënjanojnë varfërinë dhe papunësinë, të cilat, sot për sot, janë problemet më akute dhe brenga më e madhe e qytetarëve. Në vend të tyre, nevojitet një përparim i rëndësishëm dhe i vlefshëm, i bazuar në një zhvillim të qëndrueshëm njerëzor, të cilën e siguron kapitali social. Një zhvillim i qëndrueshëm njerëzor me kapital të lartë social sigurohet vetëm me stabilitet, shoqëri kohezive, me njeriun në qendër, dhe pastaj konsolidon demokracinë, krijon kushte për një jetë më të mirë të qytetarëve dhe qasje më të mirë dhe të barabartë në shërbimet publike, si dhe barazi të plotë gjinore, etnike, fetare etj.

Zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia e qytetarëve shikohen, maten dhe përcillen nga këndi i Indeksit të Zhvillimit Njerëzor. Me zhvillim njerëzor, duhet nënkuptuar procesi rritës i shtimit dhe i përparimit të orientuar drejt përmirësimit të jetës së përgjithshme të qytetarëve në një shoqëri. Ky koncept, njerëzitet, nevojat dhe dëshirat e tyre i vendos në qendër të tij. Si i tillë, zhvillimi nuk nënkupton dhe nuk duhet të nxisë gjithnjë ndryshime revolucionare, por ndryshime të qëndrueshme dhe të përhershme, që mund të jenë edhe evolutive, por të cilat sigurojnë mirëqenie ekonomike, stabilitet dhe kohezion shoqëror, drejtësi dhe barazi sociale, sundim të ligjit dhe barazi të plotë të qytetarëve para ligjit.

Për arritjen e zhvillimit njerëzor, roli i arsimit është shumë i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm. Nga ekonomistët, si: Adam Smith, D. Dikardo, Helvecius, Robert Oven, Fillip Kums e shumë të tjerë, në ta kaluarën dhe sot, arsimit është konsideruar kategoria më e dobishme ekonomike. Këto mendime largpamëse janë vërtetuar gjatë shekullit XX dhe vërtetohen nga shkencëtarët dhe studiuesit e shumtë edhe sot, të cilët me gjenialitetin e tyre u kanë dhënë hove të fuqishme zbulimeve shkencore dhe politikave zhvillimore arsimore.

Në funksion të vërtetimit të tezës së mësipërme do të theksojmë përkushtimin e disa figurave eminente botërore, të cilët rolin e cilësisë së arsimit për zhvillimin e shoqërisë e konsideronin si përcaktuesin kryesor. Hauard Gardner, themelues i Teorisë së Inteligjencave të shumëfishta, deklaroi: "Qoftë kur jam duke udhëtuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose duke vizituar Evropën, Amerikën Latine apo Lindjen e Largët, kudo gjej një konsensus mahnitës: ky është besimi se cilësia e sistemit arsimor të një kombi do të jetë një nga përcaktuesit

kryesor – ndoshta më kryesorët gjatë shekullit të ardhshëm edhe më tej”. Ndërkaq, Jack Delors deklaroi se nuk ka dhe nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë, pa sistem të arsimit cilësor. Po ashtu, Lyndon Johnson, ish-kryetar i ShBA-ve, sa ishte kryetar, pati deklaruar se: ”Në tavolinën ku unë qëndroja kam mësuar një të vërtetë të madhe. Përgjigja për të gjitha problemet kombëtare – problemet e botës, vërtitet për një fjalë të vetme. Ajo është arsimit”. (Delors, J. 1999: 22)

Shembulli më i freskët dhe domethënës është përkushtimi i Ronald Regan, i cili me ardhjen e tij në krye të SHBA-së, vendosi që të bëjë ndryshime thelbësore në Sistemin e Arsimit të Amerikës, për t’i dhënë hov zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik të vendit, për krijimin e qytetarëve amerikanë që do të jenë përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm të Amerikës. Për këtë qëllim, ai formoi më shumë se 700 grupe ekspertësh të njohur botërisht. Këto grupe të punës kishin për qëllim të konstatojnë “shëndetin” e sistemit arsimor në ShBA. Pas analizës së bërë, grupet e punës - të zhgënjyera me gjendjen e arsimit, e shkruan një raport, me titull: “Kombi para rrezikut”. Mbi bazat e këtij raporti, u hartua projekti për ndryshimin dhe transformimin radikal të sistemit të arsimit. Ky projekt mbante titullin: ”Projekti për shkëlqimin e sistemit të arsimit në ShBA”. Në projekt ishte hedhur vizioni që ShBA, në vitin 1995, të jenë e vetmja superfuqi në botë.

Përvoja të zhvillimeve dinamike mbi bazat e arsimit cilësor gjatë shekullit XX dhe fillimshekullit të ri kemi në Finlandë, Tajvan, Korenë e Jugut, Japoni dhe, së fundi, në Indi. Qytetarët e këtyre vendeve, si për politikën zhvillimore, ashtu edhe për jetën e përditshme, sot përgjigjen kështu: “Nëse dëshiron zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie të popullsisë, duhet arsim cilësor dhe mësues të paguar mirë”.

Këtë ide me sa duket, duhet introjektuar brenda politikave tona zhvillimore dhe të mendimit e të veprimit të lidërsipit në rajonin tonë. Themi duhet introjektuar në mendimin dhe veprimin praktik, sepse nuk mjafton vetëm ta dish, por edhe ta bësh. E themi këtë, sepse gjatë gjithë kohës liderët kryesorë të rajonit e sidomos ato shqiptarë deklarojnë se arsimit për ta është prioritet. Por, për fat të keq të qytetarëve, ky ishte dhe mbetet vetëm prioritet i deklaruar, që fare nuk u përmbush, sepse nuk u ndërmorën hapa për t’i jetësuar deklaratat e këtilla. Duke u nisur nga këto konstatime dhe nga qasja e re e trajtimit të zhvillimit të qëndrueshëm nga aspekti i qasjes së zhvillimit njerëzor, komponentë – shtyllë e të cilit është - cilësia e sistemit të arsimit, në mënyrë sa më urgjente dhe vendimtare duhet ndërtuar strategji gjithëpërfshirëse për

reforma në sistemin arsimor i cili paraqet themelin dhe bazën e fuqishme të ndërtimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të potencialit njerëzor.

Cilësia e arsimit në funksion të zhvillimit njerëzor dhe kapitalit social

Teoria e zhvillimit njerëzor e njeh dhe e pranon rolin e arsimit në përgjithësi dhe në kuadër të tij e njeh edhe rolin që ka në zhvillimin njerëzor apo human. Me zhvillim njerëzor nënkuptohen të gjitha kompetencat dhe karakteristikat e individit që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Vënien në funksion - zbatim të këtyre kompetencave dhe të karakteristikave të individit, zhvillimi njerëzor e shndërron në kapital njerëzor. Në këtë kontekst, mund të flasim edhe për dijen dhe kapitalin e dijeve. Posedimi i dijeve nuk identifikohet me kapitalin e dijeve. Kapital të dijeve kemi vetëm atëherë kur dijet vihen në funksion dhe kur ato gjenerojnë dije dhe aftësi të reja. Vetëm kapitali i dijeve është në funksion të zhvillimit njerëzor e jo dijet që nuk vihen në zbatim dhe nuk prodhojnë dije dhe aftësi të reja.

Sipas analizës së OECD-së, fitimi që gjenerohet nga investimi në arsim mund të manifestohet me të ardhura më të larta, me lidhshmëri më të madhe me tregun e punës, me shëndetin më të mirë dhe me një sërë përfitimesh të tjera jo monetare. (Blondal, Field, Girouard, 2002: 54). Shikuar nga ky aspekt, investimi në arsim është pjesë e një politike të përgjithshme të zhvillimit. Ajo që këtë politikë e bën shumë specifike është karakteri i saj strategjik afatgjatë. Gabimet konceptuale në politikën arsimore rezultojnë me pasoja të prolonguara, të cilat, së pari, janë të hetueshme në tregun e punës në formën e debalancimit të ekuilibrit ndërmjet ofertës dhe të kërkesave për profesione e që, më pas, manifestohet në ngecjen e përgjithshme ekonomike.

Politikat arsimore nuk janë produktive vetëm në kuadër të zhvillimit njerëzor dhe të kapitalit njerëzor, por edhe në kuadër të kapitalit social, sepse përmes procesit arsimor mund të ndikohet në rritjen e kapitalit social, që përfshin rrjetet sociale, normat dhe vlerat ndërmjet individëve në shoqëri .

Lidhur me ndikimin e politikave arsimore jo vetëm në fushën e kapitalit njerëzor, por edhe kapitalit social, Fukuyama deklaron: “lëmia ku qeveritë kanë gjasa më të mëdha të gjenerojnë kapitalin social është arsimiti”. Organizatat arsimore nuk bartin vetëm kapitalin njerëzor, por bartin edhe kapitalin social në formën e rregullave dhe të normave.

Arsimi cilësor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm

Shekulli XXI na mundëson (falë edhe demokracisë) kontaktin e vazhdueshëm me botën. Ajo që kishte munguar ndër vite për vendet postkomuniste, tashmë, është një realitet i ditës, por mbi të gjitha i domosdoshëm. Në këtë rrafsh, ky kontakt merr vlera njohëse, reflektuese, kërkuese e shkencore, njëkohësisht.

Nga ana tjetër, vendet e rajonit që përqaftuan me vullnetin e tyre demokracinë, për gati çerek shekulli, mbeten të dyzuara në një udhëkryq që ne e njohim si tranzicion, por që realisht më shumë duket se është një ngërç që vjen nga mungesa e modeleve të qëndrueshme të zhvillimit. Gjatë kësaj periudhe 25-vjeçare, rajoni ka pësuar ndryshime kaq të shumta dhe të shpeshta, saqë spontaniteti, mungesa e zbatueshmërisë së ligjit dhe mungesa e një kulture të qëndrueshme e kanë penguar ndërtimin normal dhe të nevojshëm të shoqërive mbi parimet e demokracisë, pasojë e së cilës është zhvatja e resurseve ekonomike, politike dhe kulturore pa kritere, që shoqërohet me gjendjen e apatisë dhe paperspektivës evropiane të rajonit. Brezat e nesërm, sigurisht, do të na fajësojnë për mjedisin që do të trashëgojnë nga ne apo dhe për burimet që po u lëmë. Dhe mbi të gjitha, modeli i zhvillimit është pa sens dhe i deformuar, jashtë çdo standardi që bota globale po përcakton.

Duke parë shqetësimin global për modele të zhvillimit të qëndrueshëm, duke parë se sa shumë mendim dhe studim shkencor po investohet drejt problemeve të trashëgimisë mjedisore, ekonomike dhe kulturore është gati e pamundur të mos vëresh nevojën që ka rajoni dhe vendi jonë për të kuptuar zhvillimin, si nevojë për zhvillim të qëndrueshëm dhe për të kuptuar sfidën tonë të arsimit si arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një zhvillim që i përgjigjet nevojave aktuale, duke mos kompromentuar kapacitetet e brezave të ardhshëm në plotësimin e nevojave të tyre. Si i tillë, ky zhvillim është ekonomik, social e ambiental; por mbi të gjitha është problem edukimi, pasi janë burimet humane ato që e realizojnë një model të tillë zhvillimi.

Strategjitë e para evropiane morën formë me shekullin e ri, pra në vitin 2000. Por, pesë vite më vonë, këto strategji u ripanë, me parimin e integritit të arsimit dhe politikave mbi ambientin dhe për ambientin. Ndër objektivat bazë të këtyre strategjive qëndron edukimi nëpërmjet arsimit, si motori kryesor për lëvizjen në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm.

Në Strategjinë e BE-së përcaktohet se: “Përpyekje të veçanta duhet të bëhen në fushën e edukimit dhe trajnimit të sa më shumë njerëzve, për të nxitur ndryshimin e sjelljes dhe për të pajisur qytetarët me aftësitë e nevojshme për të arritur objektivat e vendosur. Për më tepër, kërkimi shkencor dhe teknologjik duhet të inkurajohet, veçanërisht nëpërmjet programeve kornizë për hulumtim dhe zhvillim, e që duhet të lidhet me universitetet, institutet kërkimore, kompanitë” etj.

Nisur nga këto nevoja, tashmë të projektuara në strategji afatmesme e afatgjata, është i kuptueshëm dhe reagimi shumë i fuqishëm i UNESCO-s, në lidhje me arsimin për zhvillim të qëndrueshëm si pjesë e sistemeve arsimore. Krijimi dhe zhvillimi i këtyre strategjive është nevojë që përcaktohet në një nivel urgjent nga vetë shpejtësia e vendosjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm global. Edukimi i qytetarëve me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me konceptin e lirisë si përgjegjësi, është sfida jo vetëm e dhjetëvjeçarit të caktuar, por edhe e shekullit.

Pse duhet arsimim për zhvillim të qëndrueshëm? Qytetari i shekullit XXI, edhe pse nën trysinë e teknologjisë, është sërish individ i që pyet, kërkon dhe vepron sipas “unit” ose indoktrinimit. Qytetari i përgjegjshëm është qytetari i lirë. ***Të jesh i lirë do të thotë të mundësh, por edhe të dish të zgjedhësh***, në mënyrë që rezultati të përkthehet në lumturi personale dhe të komunitetit. UNESCO e konsideron këtë lloj edukimi, si detyrën e arsimimit global.

Qëllimi i këtij studimi në këtë formë ka të bëjë me problemin kyç, të vendosur në krye të punimit: A ekzistojnë në këtë vend dhe në shoqëri të ngjashme parametrat e kërkuar nga realiteti ynë global, për sistem arsimor të tillë që do të shërbejë, si instrumenti kyç në realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm? Dhe më tej: a ekzistojnë kapacitete ligjore, politike dhe humane për një edukim të tillë?

Studimet e bëra në këtë drejtim kanë vërtetuar se, në politikat arsimore të zhvilluara në dhjetë vitet e fundit, pavarësisht kryerjes së reformave dhe ndryshimeve pozitive që janë bërë, problemet me të cilat dukshëm përballet realiteti ynë kanë prodhuar edukim, por jo edukim të qëndrueshëm; kanë prodhuar arsim dhe të diplomuar, por jo standarde cilësore; kanë prodhuar qytetarë “të mirë”, por jo qytetarë të përgjegjshëm.

Modelet e përparuara, të cilat gjenden sporadikisht, mund të jenë një qasje e mirë e krijimit në të ardhmen e modeleve të qëndrueshme të arsimit, si arsim për një zhvillim të qëndrueshëm. Kjo, mendoj se duhet

të zë vendin e tyre në filozofinë e politikave arsimore, pasi bëhet fjalë për të ardhmen e cilësisë së burimeve humane. *Ky shekull do të sfidohet nga ato vende që do të kenë fituar sfidën me përgatitjen e burimeve humane, si kapital i investuar për gjithë zhvillimin e vendit, me qëllim moskompromentimin e të ardhmes së gjeneratave të tjera.*

“Dhjetëvjeçari (2005-2014)ka aktivizuar qindra dhe mijëra njerëz për të riorientuar edukimin global drejt një qëllimi kryesor: **të mësojnë për të jetuar dhe punuar qëndrueshëm**”. Ndaj këtij misioni, vendi ynë është ende në nivele modeste angazhimi. Por, në fund të kësaj dekade, Irena Bokova nga UNESCO shprehet se: “Dhjetëvjeçari ofroi një *bazë solide, të përshkallëzuar të përpjekjeve tona për të përgatitur qytetarët e së nesërme që t’i përgjigjen sfidave të së sotmes*, prandaj **nuk mund të anashkalojmë gjendjen ku ndodhemi e të mos përcaktojmë krahasimisht nevojën për një edukim për zhvillim të qëndrueshëm edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor, sikurse edhe instrumentet politike që na mundësojnë suksesshëm këtë lloj edukimi.**

Në vitin 2005, UNESCO merr rolin e drejtimit të udhëheqësisë globale për zhvillimin e qëndrueshëm dhe prodhon dokumentin i cili njihet si “Skema ndërkombëtare e implementimit të Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2005-2014” ku përcaktohen detyra për shtetet anëtare në katër përqendrime vëmendjesh kryesore të edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm;

1. përmirësimin e qasjeve për një arsim bazë (të detyrueshëm) cilësor;
2. riorientimin e kurrikulave ekzistuese drejt Edukim për zhvillim të qëndrueshëm;
3. zhvillimin e një kuptimi dhe ndërgjegjësimi publik për zhvillim të qëndrueshëm;
4. ofrimin e kualifikimeve në arsim për Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

Edukimit, dhe sistemit të tij të kualifikim-trajnitimit, ju njoh e drejta e misionit për kuptimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve dhe qytetarëve përmes adresimit në to të tre sferave të Zhvillimit të Qëndrueshëm: *shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë*. Në dokument janë të sakta adresimet **drejt sistemit arsimor** të vendeve anëtare të UNESCO-s për Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm, për të drejtat e njeriut, politikat e qytetarisë dhe qytetarit global, politikat e paqes, politikat e barazisë gjinore, politikat e reduktimit të varfërisë, politikat e migracionit, ndryshimet klimatike, politikat e urbanizimit etj. Këto adresime **do të**

fuqizoheshin nga edukimi përmes vlerave, vlera të shoqërisë ku fëmijët dhe të rinjtë jetonin, por edhe të vlerave të të tjerëve përreth tyre dhe nëpër botë, si një pjesë e rëndësishme e të edukuarit me të ardhmen e qëndrueshme të gjeneratave dhe udhëheqësve të rinj, duke e shprehur edukimin, **si burim dhe tregues të zhvillimit të qëndrueshëm** përmes formimit të qytetarit, institucioneve dhe politikave, nëpërmjet nënvizimit të vlerave njerëzore, rëndësisë së proceseve dhe vendimmarrjeve logjike, sjelljeve të përgjegjshme dhe transparente publikisht për individë, grupe, shtete. (Davis, J. M. 2010: 39).

Përfundim

Në dy dekadat e fundit, roli i kapitalit social në shoqërinë moderne vazhdon të jetë objekt i kërkimeve, debateve dhe diskutimeve teorike. Por pavarësisht prej debateve të natyrshme për një koncept relativisht të ri, kapitali social po operacionalizohet gjithnjë e më shumë si strategji efikase e zhvillimit social por edhe të zhvillimit të përgjithshëm.

Globalizimi dhe nevoja e vazhdueshme e shoqërisë për zhvillim ekonomik e ka sjellë në qendër të debateve globale konceptin e “Zhvillimit të qëndrueshëm”. Stili ynë i jetesës, që po ndryshon shumë shpejt falë ndryshimeve të vrullshme të teknologjive dhe shkencave, doemos na ka vënë përpara problemeve të mëdha, sikundër janë problemet me mjedisin. Ky term (zhvillimi i qëndrueshëm), që gjithnjë e më shumë po zë vend në tryeza të niveleve të larta politike botërore, ka sjellë në vëmendjen e të gjithëve dhe nevojën e edukimit të njerëzve sipas këtij koncepti. Por, që një model të shndërrohet në veprim, kërkon edukimin masiv të aktorëve që i shërbejnë këtij modeli. Në këtë rast, problemi i edukimit me modelin e zhvillimit të qëndrueshëm merr një përparësi jo vetëm të nevojshme, por edhe përcaktuese në rezultat. *Ndaj, asocimi i modelit të zhvillimit të qëndrueshëm me arsimin për zhvillim të qëndrueshëm përbën nevojën, por edhe sfidën e shekullit ku jetojmë.*

Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm nuk është detyrë e lehtë. Njëzet vitet e fundit kanë qenë dëshmitare të një ndërgjegjësimit në rritje të efekteve shkatërruese të njerëzimit ndaj mjedisit, por natyra dhe shkalla e shqetësimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht nga studimet substanciale të dhjetëvjeçarit të shkuar, akoma ka paqartësi shkencore për sa i përket parashikimit të së ardhmes globale mjedisore. Toka nuk është dhe asnjëherë nuk ka qenë një sistem i pandryshueshëm. Ndryshueshmëria natyrore

është dhe ka qenë një pjesë e ndërlikuar e të gjitha sistemeve mjedisore e cila me vete mbart parashtrimin e një pyetje të rëndësishme që mbetet për tu përgjigjur;

A është një vend apo komuniteti ndërkombëtar në gjendje për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm?

Përgjigjja më e mirë ndaj kësaj duhet kërkuar në faktin nëse jemi të gatshëm dhe të vullnetshëm për të instaluar vlerat shoqërore demokratike të cilat mund të arrihen përmes një performance arsimore cilësore.

Conclusion

In the past two decades, the role of social capital in modern society continues to be the subject of research, theoretical debates and discussions. But despite the controversy inherent to a relatively new concept, social capital is operationalized as ever more efficient strategy of social development but also the overall development.

Globalization and the constant need for economic development of society has brought to the center of global debates the concept of "sustainable development". Our style of living that is changing quickly thanks to rapid change of technology and science, necessarily put before us major problems, as are the problems with the environment. This term (sustainable development), which increasingly is taking place at the high table of world political levels, has brought to everyone's attention the need to educate the people by this concept. But that turned into a model of action, it requires massive education stakeholders that serve this model. In this case, the problem of education in sustainable development model takes advantage not only necessary, but also determining the result. **Therefore, the association of sustainable development model of education for sustainable development constitutes the necessity but also the challenge of the century in which we live.**

Achieving sustainable development is not an easy task. The last twenty years have witnessed a growing awareness of the devastating effects of humanity on the environment, but the nature and degree of concern have changed significantly during this period. Despite substantial research of the past decade, there is still scientific uncertainty with regard to forecasting global environmental future. The land is not and never has been a static system. Natural variability is and has been an intricate part of all environmental systems which carries with it the submission of an important question that remains to be answered;

Is a country or the international community able to guarantee sustainable development?

The best answer to this should be sought in the fact whether we are ready and willing to install democratic social values which can be accessed through a quality educational performance.

Literatura:

- Attali, J. (2015). “Becoming self”. Greentech edition.
- Blondal, Field, Girouard, (2002).
- Bourdie, P. (1986). ‘The Forms of Capital’, in Richardson, John G., ed., Handbook of Theory and Research for the Sociology of Education, New York: Greenwood.
- Bokova, I. (2014) “Shape the future we want”, Final Report 2005-2014. UNESCO.
- Coleman, James S. (1988), ‘Social Capital in the Creation of Human Capital’, American Journal of Sociology,
- Çavo, Z.(2013) “Ridimensionimi i Rilindjes” Shtëpia Botuese “Naimi”
- Davis, J. M. (2010). “Young Children and the Environment: Early Education for Sustainability”. Cambridge, Cambridge University Press.
- Dewey, J. (1916). “Democracy and education”. London: Macmillan.
- Putnam, R (2011) “Social Capital; Measurement and Consequences”, Kennedy School of Government, Harvard University